



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-139

Prishtinë, më 23 dhjetor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 DHJETOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë:

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 dhjetor 2013,
2. Vazhdimi i seancës së papërfunduar plenare, të filluar më 19 dhjetor 2013,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 dhjetor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 dhjetor 2013.

2. Vazhdimi i seancës së papërfunduar plenare, të filluar më 19 dhjetor 2013

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara të seancës së mëparshme, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 26 dhjetor 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013,*
2. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
3. *Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.*

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet më 26 dhjetor 2013, në orën 10:30, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014,*
- 4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë,*
- 6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,*
- 7. Propozimi i GP të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në Komisionin për Integritet Evropian.*

* * *

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, u deklarua se nuk do të marrin pjesë në seancë plenare në pikën e tretë nëse përfshihet amendamenti i Qeverisë së Kosovës në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 që ka të bëjë me privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

- 1. Procedimi i Projektligjit për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës*

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P e r f u n d i m

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës, të hartuar nga Komisioni për Siguri dhe Mbikëqyrjen e FKS-së, si dhe ta përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-në të këtij projektligji, në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

2. Nisma e grupit të deputetëve për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit “Hasan Prishtina”, në Prishtinë

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën e propozuar nga grupi i deputetëve nënshkrues për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, në afatin prej një muaji nga dita e pranimi.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA, prej 3-7 shkurt 2014

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Petar Miletiq, nënkryetar i Kuvendit, Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, Visar Ymeri në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

V e n d i m

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Adem Grabovci, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Flora Brovina për të marrë pjesë në Lutjet e 62-ta të Mëngjesit, në Uashington D. C., prej 3 deri më 7 shkurt 2014.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

Pikat shitesë:

1. Njoftimi i Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me përfundimin e mandatit të Avokatit të Popullit më 4 qershor 2014

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me përfundimin e mandatit të Avokatit të Popullit më 4 qershor 2014, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat të Pagjetur dhe Peticione që në përputhje me Rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit nr. 04-V-049, datë 19 maj 2011, të

shpallë konkursin për Avokatin e Popullit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Kërkesa e deputetit Elmi Reçica, mbështetur edhe nga deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me privatizimin e Fabrikës për Prodhimin e Gypave në Ferizaj

Kryesia, pas diskutimit lidhur me kërkesën e lartpërmendur, nxori këtë:

P e r f u n d i m

Kërkohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që ta përgatisë dhe Kuvendit t'ia paraqesë informatën lidhur me privatizimin e Fabrikës për Prodhimin e Gypave në Ferizaj, mbi bazën e së cilës do të zhvillohet debati parlamentar.

3. Propozimi i GP të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në Komisionin për Integritet Evropian

Kryesia e radhiti propozimin e lartshënuar në rend të ditës për seancën plenare, më 26 dhjetor 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale